

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023  
Ora 10.24**

***RENDI I DITËS***


**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 85, subjekti ankues Koalicioni  
“Bashkë Fitojmë” (Elbasani).**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Ledio Braho, Z. E. Çefa, Z. K. Bele.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike:** “Bashkë Fitojmë” ( Franci Nuri); PS ( Marenglen Legisi)

**Z. L. Braho:** Mirëmëngjesi! Çelim seancën e shqyrtimit të elementeve të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore numër 85, protokolluar në KQZ më datë 24.05.2023, ankues është subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt anikimimi kundërshtimin e vendimit numër 539 datë 20.05.2023, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe këshillin e bashkisë për zonat zgjedhore Elbasan që besoj duhet të jetë vendim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe më tej ka edhe 7 pika të tjera objekti i ankimit, të cilat për efekt kohe nuk po i lexoj. E pranishme është trupa e KAS-it, në mënyrë të plotë. Po ashtu i pranishëm është sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, i pranishëm, është përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zoti Franci Nuri, po ashtu në sallë shohim edhe një nga përfaqësuesit e Partisë Socialiste. Zoti sekretar i Përgjithshëm a keni ndonjë kërkesë paraprake?

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Prezent

**Z. M. Legisi:** Prezent

**Z. Y. Merkaj:** Po, Partia Socialiste ka paraqitur një kërkesë për t'u futur në këtë shqyrtim administrativ në cilësinë e personi të interesuar.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Zoti Legisi, me pak fjalë në lidhje me kërkesën.

**Z. M. Legisi:** Po, faleminderit, zoti kryetar! Kemi bërë një kërkesë bashkëlidhur me autorizimin për përfaqësim në këtë seancë. Vlerësojmë që vendim i përfundimtar i shqyrtimit të kësaj kërkesë mund të ndikojë në rezultatin zgjedhor dhe është një vendim mjaft i rëndësishëm që ndikon në interesat zgjedhore të subjektit që unë përfaqësoj.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Atëherë KAS-i i konsultuar në vend vendos pranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për të marrë pjesë si palë e interesuar në shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore. A ka ndonjë kërkesë tjetër paraprake në lidhje me trupën e KAS-it.

**Z. F. Nuri:** Jo nuk kemi.

**Z. L. Braho:** Fjala për sekretarin e Përgjithshëm në lidhje me elementet e formës dhe përmbajtjes së kësaj kërkesë.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Po, faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 85, me ankues koalicionin “Bashkë Fitojmë”, i cili kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ne numër 539, datë 20.05.2023, i cili ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkisë për zonën zgjedhore Qarku Elbasan për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga shqyrtimi kërkesës ankimore konstatohet se i plotëson elementet e formës dhe përmbajtjes, por edhe kemi një rezervë për objektin e ankimit, i cili është, mendojmë, që pika 1 dhe pika 7 duhet të qëndronin te objekti i ankimit pasi pikat 2,3,4,5 dhe 8 janë pjesë e shqyrtimit administrativ. Në këto kushte kërkojmë kalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim duke mbajtur parasysht pikat.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit, zoti Merkaj! Fjala për zotin Nuri. Zoti Nuri me pak fjalë sqarimin tuaj në lidhje me prapësimet që keni në lidhje me pretendimin e sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.

**Z. F. Nuri:** Faleminderit! Unë gjykoj që duhet të mbajmë të njëjtin qëndrim që mbajtëm edhe dje për rastin e Kamzës, sepse edhe ankimet janë pothuajse identike ma pak ndryshime, kështu që në thelb ne kërkojmë përveçse kundërshtojmë vendimin numër 539 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në këtë rast për rezultatit e Bashkisë së Elbasanit. Ne kërkojmë në thelb përsëritjen e zgjedhjeve në këtë bashki, kështu që gjykojmë se mund të procedojmë njësoj sikundër u vendos edhe dje. Për legjitimitimin pastaj në gjykojmë se i plotësojmë të tria elemente. KAS-i është kompetent, jemi subjekt i regjistruar rregullisht në këto zgjedhje dhe kemi paraqitur ankim brenda afatit maksimal të lejuar nga ligji, kundrejt një vendimi që ne si subjekt gjykojmë se na cenon të në të drejtat tona. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Nuri. Fjala për përfaqësuesin e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. M. Legisi:** Faleminderit! Ne nuk kemi pretendime në lidhje me këtë fazë jemi dakord të kalojmë në shqyrtim administrativ. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! A ka ndonjë pyetje nga kolegët? Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend vendos kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 85, të subjektit zgjedhor koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Seanca për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 85 do të zhvillohet ditën e enjte datë 1 qershor 2023 në ora 12:30. Seancën e deklarojmë të mbyllur.

**Vendimi nr. 147**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023  
Ora 10.32**

**RENDI I DITËS**

**Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 82, subjekti Koalicioni “Bashkë Fitojmë”**


**(Krujë).**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike:** “Bashkë Fitojmë”, (F. Nuri), PS (M. Legisi)
- **Të tjerë:** KRIIK

*Z. E. Çefa:* Mirëdita të gjithëve! Atëherë deklarojmë të hapur seancën e KAS-it, lidhur me shqyrtimin e kërkesës ankimore me numër 82, të datës 23 maj 2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” me objekt: Kundërshtimin e vendimit numër 292 dhe 293 datë 18.05.2023 “ Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit dhe të këshillit të Bashkisë Krujë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023; pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në disa qendra votimi të zonës zgjedhore bashkia Krujë, dhe rregullimin e pasojave duke proceduar me ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit përkatës duke mos përfshirë rezultatin e qendrave të votimit objekt ankimi”. Verifikojmë prezencën. Është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i palës ankimuese zoti Nuri, është prezent përfaqësuesi i subjektit të interesuar të Partisë Socialiste, zoti Legisi, është prezent, gjithashtu, sekretari i Përgjithshëm i KQZS-së së bashku me stafin e tij.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Prezent.

**Z. M. Legisi:** Prezent.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Shoh që kemi një kërkesë paraprake për saktësimin e objektit nga vetë ankimuesi. Ju lutem, zoti Nuri, shkurtimisht na relatoni.

**Z. F. Nuri:** Faleminderit! Ne morëm shkas dhe nga diskutimi i djeshëm në seancë ku na u kërkua shprehimisht që të saktësonim objektin e kërkesës ankimore. Kështu që morëm shkas nga kjo dhe pikën 2 të kërkesës ankimore deshëm ta riformulojmë ose ta saktësojmë më saktë duke kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në disa qendra votimi të Bashkisë Krujë të renditura edhe në kërkesë. Për efekt kohe ose edhe për ekonomi kohe nuk po i citojmë të gjitha sepse janë në kërkesë të cituara dhe të listuara, përfshirë dhe njësitë administrative përkatëse ku ato gjenden. Njëkohësisht ne kemi bërë kërkesë, koalicioni, në dijeninë time përfaqësuesi, zoti Kaziaj, përpara katër ditësh kishte bërë dhe kishte dorëzuar kërkesë në KQZ për vënien në dispozicion të kamerave të Qendrës së Votimit nr. 1302/1 dhe ende nuk kemi marrë një përgjigje zyrtare lidhur me këtë kërkesë. Nisur dhe nga kërkesa dhe vullneti i kandidatit tonë, zotit Loka, ne sot në mëngjes kemi depozituar në KQZ, gjithashtu, kërkesë për vënie në dispozicion edhe të kamerave lidhur me këto qendra votimi ku pretendohet se ka parregullsi. Dhe pa dashur t’ju ndërprisja do të kërkonim kohë në dispozicion dhe pse jo brenda mundësive KAS-i të shohë mundësinë të shtyhet kjo seancë themeli për sa kohe neve, si subjekt, nuk na janë vënë në dispozicion as kamera e parë, por të na viheshin në dispozicion këto materiale ose t’i shohim këtu të gjithë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Pra, po e konsiderojmë kërkesë paraprake edhe çështjen e shtyrjes së seancës, apo jo, për të administruar provat?

**Z. F. Nuri:** Po.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Zoti Nuri, ju keni saktësuar sipas kërkesës së KAS-it keni saktësuar numrin e qendrave të votimit për të cilat ju kërkoni pavlefshmërinë e zgjedhjeve?

**Z. F. Nuri:** Po në Bashkinë Krujë.

**Z. I. Rusmali:** Argumenti në kërkesën tuaj ankimore, siç e kam lexuar unë, mbase e kam gabim është një, ekzistenca në këto qendra votimi e komisionerëve, të cilët janë në kushtet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit, apo jo?

**Z. F. Nuri:** Ka pasur komisionerë, ka pasur vëzhgues në kundërshtim me procedurat dhe rregullat e Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, doja të shtoja se nga informacioni i ardhur edhe nga kandidati sot nuk e pati të mundur që të ishte prezent faktikisht për shkak të trafikut, nuk pati mundësi të vinte në kohë dhe mund ta shpjegonte edhe ai vetë, kandidati pretendon se ka pasur edhe shkelje të tjera që ne i kemi pasqyruar, si prezencë të personave problematikë në qendrat e votimit e të tjera. Pra, janë disa elemente.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është me të thënë, apo jo? Në kërkesë ankimore është vetëm pretendimi që komisionerët caktuar janë në kushte të papajtueshmërisë së ushtrimit

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

të funksioneve. Unë nuk e di ë vëzhguesit mund të jenë në kushtet e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksioneve, por ky është diskutim tjetër. Në kërkesën ankimore përmenden tre emra komisionerësh. Nuk kuptohet qartë, janë të tre anëtarë të KZAZ-së apo është një i KZAZ-së dhe dy të Komisioneve të Qendrave të Votimit?

**Z. F. Nuri:** E kuptoj shumë mirë qëndrimin tuaj. Çështja është se sikundër thashë edhe dje në seancë ankimi në atë moment u bë për të zënë afatin, ndërkohë informacionet e ardhura edhe dje, na kanë bërë me dije se për shembull ka pasur dhunë ndaj komisionerit tonë, zotit Hyka, në qendrën 1302/1 për të cilën janë kërkuar edhe kamerat 4 ditë përpara. Pra, kanë dalë edhe elemente të tjera që ne me këtë rast kur kemi plotësuar dhe saktësuar edhe objektin, po jua parashtrojmë edhe juve. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Ju sot na kërkuat vetëm t'ju ndihmojmë që t'ju vihen në dispozicion regjistrimet, apo jo? Nëse kërkesa ka pretendimin që komisionerë të caktuar janë në kushtet e papajtueshmërisë, në konflikt interesi me gjuhën e zakonshme, prova që kërkohet të hulumtohet, është vendimmarrja e tyre ka pasur ndikim në vendimmarrjen e organit apo jo, për të kuptuar nëse konflikti i tyre i interesit është shndërruar në konflikt të trupës apo jo. Kjo është lidhja logjike midis pretendimit dhe provës. Çfarë lidhjeje ka rinumërimi lidhur me këtë pretendim, me pretendimin për ushtrimin e detyrës në kushtet e papajtueshmërisë?

**Z. F. Nuri:** I nderuar ne nuk kemi kërkuar rinumërimin, por kemi kërkuar pavlefshmërinë e tri qendrave të votimit. Lidhja ka qenë fakti...

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. I. Rusmali:** Kërkoj ndjesë gabimi im. Çfarë lidhje kanë vlerësimi fletëve të votimit për të cilin ju kërkoni filmimet me funksionimin e disa personave në administratën zgjedhore që nuk kanë marrë pjesë në fletët e votimit. Lidhja në gjykimin tonë është e evidente, sepse nuk janë zbatuar procedurat dhe nuk është zbatuar Kodi Zgjedhor, nuk janë zbatuar rregullat e votimit të Kodit Zgjedhor dhe prandaj dhe subjekti dhe kandidati kërkojnë vënien në dispozicion të kamerave në mënyrë që të hulumtohen dhe evidentohen me prova të pakundërshtueshme prezenca e personave po themi që nuk kishin punë fare brenda qendrave të votimit apo në distancën brenda 150 metrave të lejuara nga Kodi Zgjedhor, të cilët, në gjykimin tonë, kanë intimiduar apo kanë ndikuar te zgjedhësit.

**Z. I. Rusmali:** Pa dashur të bëhem i bezdisshëm, zoti Nuri, konflikti ka lidhje me interesin privat të një personi, i cili i transmetohet vendimmarrjes së organit kolegjial. Për të kuptuar nëse personi ka vepruar në konflikt interesi duhen shqyrtuar vendimet që ka marrë trupa. Vendimet që ka marrë trupa gjenden në librin e protokollit të KQV-së nëse trupa është KQV, dhe të KZAZ-së, nëse trupa është KZAZ. Këtë pretendim ju e mbështesni vetëm me këto prova. Pse kërkoni një prove tjetër, është pyetja ime?

**Z. F. Nuri:** Ne kërkojmë provën filmike, sepse nëpërmjet filmimeve mund të evidentohen më konkretisht edhe personat e tjerë, që mund të kenë qenë prezent. Në kërkesë janë relatuar sikundër jua thamë 3 emra që na kanë ardhur nga dega, por nëpërmjet kamerave mund të evidentohen edhe persona të tjerë. Ata i njohin më mirë se ku punojnë ku janë, a janë në konflikt interesi në detyrat e tyre e të tjera. Ne gjykojmë se është e drejta jonë që ta kërkojmë këtë informacion. Megjithatë KAS-i do ta gjykojë dhe do ta vendosë.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. I. Rusmali:** Ne e kemi diskutuar edhe herë tjetër dhe është linjë e qëndrueshme e kësaj trupe. Pretendimi, thotë ligji, ngrihet mbi bazën e provave. Ju kërkoni regjistrimet, që të shihni nëse mund të gjeni ndonjë provë, apo jo? Ju e keni pretendimin të ngritur. Në qoftë se ju thoni X persona kanë qenë në kushtet e papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit, ju dini identitetet e personave dhe shkakun e papajtueshmërisë, ju nuk mund ta kërkoni mbasi keni ngritur pretendimin. Kjo është rruga ligjore, apo jo?

**Z. F. Nuri:** I nderuar, janë paraqitur disa emra, janë paraqitur edhe funksionet e tyre, po për momentin kandidati, nëse do të ishte prezent, jam i sigurt se do të kishte prezantuar edhe emra të tjerë dhe persona të tjerë, duke qenë se i ka ndjekur dhe e njeh më mirë terrenin dhe zonën, prandaj jemi në këto kushte. Ne nuk po kërkojmë marrjen detyrimisht të provave, sepse nuk kemi prova, ne kemi prova, kemi fillim provash, sikundër është rasti, për shembull, i zotit Hykaj, i dhunuar dhe i cili e ka denoncuar edhe në polici rastin e tij. Ky duhet të jetë një fakt i njohur botërisht, që dhe Kodi Zgjedhor parashikon si një provë që mund të merret në konsideratë nga KAS-i. Është rast i pasqyruar edhe nga media, në dijeninë tonë. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Një pyetje: pra në praktikën e zgjedhjeve, në rastet kur për anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit apo të KZAZ-ve ka probleme papajtueshmërie, këto janë ngritur në mënyrë sistematike para dhe gjatë procesit të votimit, si dhe gjatë procesit të numërimit. Është bërë ndonjë kërkesë e tillë nga ana e kandidatit për ndonjë përjashtim pranë KQZ –së, për këta emra apo emra të tjerë? Në dijeninë tuaj nëse ..

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Në dijeninë time, nuk jam në dijeni nëse është bërë një kërkesë e tillë apo jo nga kandidati.

**Z. K. Bele:** Sepse këtu janë 3 emra pa thënë se çfarë punë bëjnë ata dhe veç personit që është kryetar KZAZ-je dhe 2 drejtorë shkolle.

**Z. F. Nuri:** Është nëndrejtoreshë tatimesh, për zonjën...

**Z. K. Bele:** Se çfarë kanë bërë brenda apo jashtë qendrës së votimit dhe se si do merret aktiviteti i këtyre njerëzve, i pretenduar në shkelje të ligjit nga kamera e qendrës së votimit, unë nuk e kuptoj, se unë gjithmonë kam qenë personalisht pro dhënies provës, qoftë edhe për të davaritur tymin e keqkuptimit që s'na u dha prova. Mirëpo që të kërkosh një provë, duhet minimumi të arsyetosh në mënyrë skematike se ku do të çojë kjo provë. Pra, unë po dal përtej qëndrimit ose po mbaj një qëndrim tjetër nga ajo që, me të drejtë arsyetoj kolegu Rusmali, supozojmë se do ta marrin provën si *fictio expeditio*, flas si një fushatë për të gjetur shkeljen, por minimumi duhet të themi që duke marrë këtë gjë, do të provojë që personi X, Y, Z, para jashtë qendrës, brenda qendrës ka kryer, pra, duhet ngrihet në nivel pretendimi. Unë këtë se shoh të arsyetuar. Janë 61 bashki dhe ka ankime pa fund, nëse ne do të fillojmë me këtë nivel kërkimi, të pranojmë të merren kamerat, të hapen kutitë, thjesht do të rrimë 3 muaj këtu, do të bëjmë një teatër, që nuk e di sa i vlen cilësisë së procesit zgjedhor dhe në këtë kuptim ju jeni përfaqësuesi ligjor i kandidatit, por duhet të jemi të gjitha palët të ndërgjegjshme që kemi detyrime edhe ndaj cilësisë së procesit, por edhe zgjatja e ankimeve pa shkak ndikon në këtë. Kështu që do të lutem, pa dashur të bëj unë leksion këtu.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Jo, ju falënderoj, i nderuar, për ndërhyrjen! Unë u përpoqa ta argumentoj në fillim arsyen pse i kërkuam kamerat dhe kandidati e ka kërkuar vënien në dispozicion të kamerave në këto qendra votimi, pikërisht për ato që ju thatë në lidhje me personat problematikë të ndodhur në ato qendra, në afërsi të atyre qendrave, brenda qendrave të votimit, të cilët i merrnin personat, i shoqëronin, sipas pretendimeve të tij, deri në votim etj, etj. Prandaj ndoshta është përtej argumentit të konfliktit të interesit. Jam dakord që mund të jetë përtej konfliktit të interesave të komisionarëve apo të vëzhguesve, por aty është e sigurt që do të dalin shkelje të tjera, të natyrave të tjera, që janë dhe përbëjnë shkelje të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Dakord, se s'dua të zgjatem, por kamerat e qendrës së votimit, në kuptueshmërinë time, Ylli, në qoftë se unë e kam drejt, kamera e qendrës së votimit fokuson qendrën, nuk tregon perimetrin e shkollës, Pra, KQZ-ja nuk ka arritur akoma të vendosë kamera në lagje, që të tregojë që ata i marrin për dore ato. Kështu që unë këtë kisha të paktën...

**Z. F. Nuri:** Të paktën, nga informacioni që na u përcoll për kamerat e herës së kaluar, kamerat ishin 360 gradë brenda qendrës së votimit. Po, jam dakord për kamerat, po përderisa për personat kemi pretendimin që janë futur edhe brenda dhe kanë shoqëruar votues të caktuar, nga këto elemente do të shihet mjaft mirë. Të paktën, ky është pretendimi edhe i kandidatit tonë. Kështu që, ju do ta gjykoni më mirë si KAS, se si do ta vlerësoni këtë çështje. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Atëherë, kam edhe unë një pyetje, meqenëse u debatua pak dhe elaburoi situata, për sekretarin e Përgjithshëm. U pretendua se përfaqësuesi tjetër i

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

koalicionit, zoti Kaziaj, ka bërë ditë më parë një kërkesë për vënien në dispozicion të kamerave për një qendër votimi, apo jo, zoti Nuri? Për një qendër votimi ishte kërkesa e Kaziajt?

**Z. F. Nuri:** Po, nga informacioni që m'u dha ishte vetëm për qendrën e votimit 1302/1, ku ka ndodhur dhe dhunimi i zotit Hykaj.

**Z. E. Çefa:** E kuptoj. A ia keni vënë në dispozicion atë? Dhe pjesa tjetër e pyetjes: nëse eventualisht sot është administruar kërkesa e re e koalicionit dhe për këto kamerat e qendrave të tjera të votimit, sa kohë do t'ju duhet për t'ia vënë në dispozicion?

**Z. Y. Merkaç:** Për këtë qendrën e votimit, unë po flas në përgjithësi, çdo kërkesë që bëhet në subjektet zgjedhore protokollohet në KQZ, në mënyrë formale dhe të gjithave kërkesave të subjekteve i jemi përgjigjur, i kemi dhënë të gjitha pamjet filmike. Në rastin konkret nuk e di të them për momentin, në qoftë se është bërë kërkesa me shkrim dhe është gati, megjithatë për kërkesën për plotësim, që bëri përfaqësuesi i koalicionit "Bashkë Fitojmë", për diku te 20 qendra votimi, besoj që e kemi dhe për 24 orë e plotësojmë, vetëm thjesht duhet të na vënë në dispozicion një pajisje hard disku të jashtëm që t'i hedhim.

**Z. F. Nuri:** Sapo më informuan nga IT-ia e subjektit tonë që hard disku është depozituar në protokollin e KQZ –së, pikërisht për Krujën.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. E. Çefa:** Po dakord. Pyetje të tjera nga kolegët? Jo. Kemi nevojë ta ndërpresim, që të diskutojmë çështjen e vendimmarrjes, apo jo? Dakord, atëherë do të na jepni 5 minuta kohë. Do ta ndërpresim seancën këtu. Faleminderit!

**Rifillon seanca**

**Ora, 11:02**

**Z. E. Çefa:** Riçelim edhe një herë seancën. Atëherë KAS-i, pasi e diskutoi çështjen e kërkesës paraprake të palës ankimuese, me shumicë votash vendosi rrëzimin e saj dhe mospranimin e kërkesës për shtyrjen e seancës, për shkak të administrimit të kamerave për qendrat e votimit, që është kërkuar në kërkesë. Atëherë, në këtë fazë do të vijojmë aty ku e lamë, duke ia dhënë fjalën sërish ankuesit për të parashtruar tashmë në themel kërkesën ankimore, objekt i këtij shqyrtimi administrativ. Fjala për ju, zoti Nuri.

**Z. F. Nuri:** Po, faleminderit, i nderuar, relator! Atëherë sikundër jeni edhe në dijeni ne kundërshtojmë zgjedhjet në Bashkinë e Krujës, në qendrat e votimit për të cilat sot kërkuam edhe saktësimin e objektit të kërkesës ankimore. Pa hyrë te pjesa e legjitimit, sepse këtë e diskutuam edhe herën e parë, shkurtimisht ne pretendojmë se në disa qendra votimi në Bashkinë e Krujës ka patur persona të cilët janë emëruar komisionerë ose mund të kenë qenë edhe vëzhgues, në raste të caktuara, në kundërshtim me ligjin dhe me përcaktimet e Kodit Zgjedhor. Kemi listuar disa emra konkretë, pa dashur t'i citojmë publikisht, të cilët në ditën e zgjedhjeve kanë patur poste që varehin nga Bashkia e Krujës, dhe në vlerësimin tonë kanë patur konflikt interesi dhe nuk duhet të ishin zgjedhur si anëtarë të komisioneve për sa kohë vetë kandidati që rikandidonte ishte edhe kryetari i Bashkisë së Krujës. Pra,

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

automatikisht, në vlerësimin tonë, ka patur konflikt interesi, në kundërshtim kjo me nenin 39 pika 2 të Kodit Zgjedhor. Po të na ishin vënë në dispozicion edhe kamerat filmike, do të kishim vënë re dhe do të kishim arritur të provonim përtej dhunës, që është zhvilluar në qendrën e votimit në Krujë, ndaj komisionerit tonë të qendrës 1302/1, përtej këtij rasti të bërë edhe publik, do të kishim konstatuar edhe prezencë të shtuar të aktivistëve, të patronazhistëve të Partisë Socialiste dhe të elementëve të tjerë, persona problematikë ose me precedentë penalë prezent në ambientet e qendrave të votimit në distancë nën 150 metra, të cilët, në vlerësimin tonë, kanë kryer presione, ose kanë ushtruar presione ndaj votuesve. Gjithsesi nuk i kanë lejuar ata të shprehen lirshëm, të votojnë lirshëm dhe mund të kenë cenuar, në raste të caktuara, edhe fshehtësinë e votës. Për të gjitha këto arsye, pa dashur të zgjatemi, ne kërkojmë pranimin e kërkesës sipas objektit të saj. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit, zoti Nuri! Atëherë përfaqësuesi i palës së interesuar, keni diçka në këtë fazë për të thënë?

**Z. M. Legisi:** Po, faleminderit, i nderuar! Shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkelje që i pengojnë, largojnë zgjedhësit në masë nga votimi ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që i tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Kjo është një praktikë tashmë e mbajtur nga Komisioni i Sanksioneve dhe Ankimeve edhe i bërë për vete, le të themi, aprovuar edhe nga Kolegji Zgjedhor. Nëse do të vërejmë kërkesën ankimore në tërësi apo shkakun për të cilën pretendohet, nisur edhe nga debati në lidhje me administrimin e provave që u bë më përpara, vlerësojmë që ka nota të theksuara paragjykimi, sepse edhe personat të cilëve u është atribuar një shkelje e caktuar, emri nuk është shoqëruar me pozicion apo me detyrën, apo me funksionin që ka patur në procesin zgjedhor, por është

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

shoqëruar me pozicionin që ata kanë në administratën publike. Pra, një emër i caktuar ka një pozicion administratën publike dhe për rrjedhojë për faktin që ai ka qenë pjesëmarrës, le të themi, apo mund të ketë marrë pjesë në procesin zgjedhor, atëherë duhet të jetë cenuar procesi zgjedhor në atë masë që e bën të pavlefshëm të tërë atë proces si të tillë. Në tërësi, ne vlerësojmë që kërkesa nuk është e arsyetuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë dhe detajuar për pasojën e tyre. Rrjedhimisht kjo kërkesë duhet rrëzuar nga Kolegji si e pabazuar në ligj dhe në prova. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Zoti Merkaj, jo domosdoshmërisht, nëse keni diçka për të thënë në këtë fazë, por nuk është e thënë që detyrimisht duhet të thoni diçka.

**Z. Y. Merkaj:** Ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke qenë se pala ankuese ka... Kodi Zgjedhor dhe KQZ-ja u ka krijuar të gjitha mundësitë palëve që janë në proces, aq më tepër që pala ankuese ka pas anëtarë si te komisioni i qendrës së votimit, si te KZAZ-ja, si te grupi i numërimit. Ka libra protokollit, ka tabelë përmbledhëse të rezultatit, ku në qoftë se kanë vërejtje anëtarët e grupit të numërimit, shënojnë vërejtjet. Në asnjë nga këto materiale, as në librin e protokollit të KZAZ-së, as në librin e protokollit të QV –së nuk ka vërejtje të shënuara nga përfaqësuesit e subjektit zgjedhor të koalicionit “Bashkë Fitojmë” për zgjedhjet e Bashkisë së Krujës. Në këto kushte, kur nuk ka asnjë provë që të pranohet kërkesa e palës ankuese, kërkojmë rrëzimin e kërkesës. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Nga kolegët ka ndonjë pyetje? Nuk ka. Atëherë praktikisht do të kalojmë te konkluzionet, të cilat formalisht duhet t'i fillojmë edhe një herë me palën ankuese.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. F. Nuri:** Faleminderit! Do t'i qëndrojmë kërkesës sonë, gjithsesi, kërkojmë pranimin e kërkesës nga KAS-i si të bazuar në ligj dhe në prova. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Personi i interesuar.

**Z. M. Legisi:** Po faleminderit, i nderuar! Kërkojmë rrëzimin e kërkesës. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit, zoti sekretar i Përgjithshëm!

**Z. Y. Merkaj:** Rrëzimin e kërkesës.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Atëherë KAS-i do të tërhiqet. Meqenëse gjatë kohës që po diskutonim, ne i konsuamam disa elemente kryesore të çështjes, po vlerësojmë që ta shpallim tani në vend edhe vendimin përfundimtar për çështjen. Pra, KAS-i, i konsultuar në vend, me shumicën e votave vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 82 të subjektit zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ –së. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda afatit të përcaktuar në ligj. Me kaq, kjo seancë deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 148**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023  
Ora 11:16**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 73, subjekti ankues  
ADK” Gjirokastër.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Ledio BRAHO, Z. Koli BELE.

**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

**Të tjerë:** KRIIK.

**Z. E. Lako:** Atëherë çelim seancën për çështjen ankimore numër 73, të depozituar nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me objekt kundërshtimin e veprimit numër 196, datë 18.05.2023, të KZAZ-së numër 80, Gjirokastër, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Gjirokastër dhe shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në QV-të 43/10, 42/62, 42/42. Atëhere në seancën e fundit ku i pranishëm ishte dhe pala ankuese, ne sipas kërkesës që bëri pala ankuese nuk morëm dot vendim për mosplotësim korumi, për t'i dhënë kohë për të marr pamjet filmike dhe e shtymë për ditën e sotme këtë seancë, në mënyrë që të kishim mundësi që të kishim korum në marrjen e këtij vendimi. Konstatojmë nga administrata që pala ankuese është njoftuar rregullisht apo jo zoti Merkaj?

**Z. Y. Merkaj:** Po, është njoftuar rregullisht dhe nuk është paraqitur.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. E. Lako:** Dhe nuk është paraqitur në seancën e sotme. Në këto kushte meqënëse nuk mundet që pala ankuese të na sqarojë që çfarë ndodhi me provat i mori apo jo, mundet ju të na thoni a patët ndonjë kërkesë nga pala ankuese për marrjen e provave.

**Z. Y. Merkaj:** Po, megjithëse në seancën e mëparëshme të KAS-it iu sygjera ankuesit që të bënte kërkesë, të propozonte kërkesën për marrjen e pamjeve filmike për 3 Qendrat e Votimit që pretendohet në ankim, pranë protokollit të KQZ-së nuk është paraqitur asnjë ankesë, kërkesë për marrjen e pamjeve filmike. Në këto kushte nuk i kemi dhënë, nuk i ka marr, ai nuk ka paraqitur kërkesë për t'i marr këto pamje.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Merkaj, nga sekretaria na u depozituan përsëri në emër të këtij ankimi nja dy kërkesa si plotësim, kjo e fundit që më është vënë në dispozicion nuk flet më as për këto QV-të, por thjesht thuhet ca fjalë të përgjithshme në lidhje me procesin e numërimit, pra nuk është është se është depozituar asnjë provë konkrete se çfarë pretendohet, kështu që përse i përket kërkesës që bëri atë ditë subjekti dhe ai nuk e ka ushtruar këtë kërkesë as pranë KQZ-së, mendoj se është ezauruar apo jo kolegë? Kështu që përderisa ne e konsiderojmë që sot nuk ka më kërkesë, athere nëse ka ndonjë pyetje nga kolegët për administratën në lidhje me këtë çështje, nuk ka. Atëhere kalojmë te pjesa e konkluzioneve. Zoti Merkaj ju çfarë kërkoni?

**Z. Y. Merkaj:** Ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në prova.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, atëhere KAS do tërhiqet për vendim. Atëhere KAS i konsultuar në vend vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë ankimore, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditësh në Kolegjin Zgjedhor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë, faleminderit!

**Vendimi nr. 149**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

26.05.2023  
Ora 12:30

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 77,  
subjekti ankues APLZHK” Kurbin.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli BELE.

**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

**Të tjerë:** KRIIK.

**Z. K. Bele:** Mirë, çelim seancën publike të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës numër 77, të subjektit Aleanca Progresiste LZHK, me objekt kundërshitimim e vendimit numër 74, datë 17.05.2023, për KZAZ-në numër 15, Kurbin. Relator i kësaj seance jam unë Koli Bele, KAS në përbërje me 4 anëtare prezent si dhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Sqarojmë se në këtë fazë të procesit ne verifikojmë vetëm elementët e formës dhe të përmbajtjes. Në kërkesë paraprake këtu lidhur me legjitimitetin tonë apo ankime nga palët nuk kemi deklarime, konstatojmë gjithashtu prezent këtu, zotëri të lutem me rekord.

**Përfaqësuesi APLZHK:** Rizaldo Vrenozi me autorizim që në fillim të periudhës zgjedhore si përfaqësues.

**Z. K. Bele:** Dakord, përfaqësuesi i subjektit, palë të tjera nuk kemi, në këtë fazë pyesim Sekretarin e Përgjithshëm shkurtimisht çfarë ka për të thënë për kërkesën.

**Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Nga shqyrtimi, nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore, përcaktohet se i plotëson elementët vetëm se është një provë që nuk ishte paraqitur në dokumentat e ankesës. Pretendohet në ankesë që është një Qendër Votimi që është shpallur e pavlefshme nga KZAZ-ja, dhe këta pretendojnë që, pala ankuese, nuk është dëmtuar në atë masë që të quhet e pavlefshme. Do të ishte mirë të kishim një libër të protokollit të KZAZ-së bashkëlidhur ankesës të shohim që..., elementët e tjerë i plotëson kërkesa për të kaluar në seancë.

**Z. K. Bele:** Po, ankuesi.

**Përfaqësuesi APLZHK:** Faleminderit i nderuar. Provat janë ato që kemi mundur të marim nga KZAZ-ja dhe ato prova kemi paraqitur bashkëlidhur ankimit.

**Z. I. Rusmali:** Kopje të librit të protokollit, të fletës ku është marr vendimi për deklarimin të parregullt të kutisë, nuk e keni?

**Përfaqësuesi APLZHK:** Nuk e kemi, nuk e disponojmë.

**Z. I. Rusmali:** Domethënë ju e keni me gojdhënë, ne mund të vihemi dhe përpara faktit që...

**Z. K. Bele:** Kanë një kopje të, në tabelë është një shënim që pasqyron këtë, se tani e mora të pastër, ka të drejtë se nuk lexohet te fotokopja po në tabelën e rezultatit është një shënim që në datën 14.05 grupi i marrjes në dorëzim nga KZAZ, ka konstatuar

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

se kutia numër 70, për kandidimin për këshill, ka qënë e dëmtuar. KZAZ numër 15 ka vendosur që kjo kuti votimi të konsiderohet si e parregullt, duke mos e kaluar për numërim në GNV, gjë për të cilës është njoftuar dhe KQZ-ja. Kjo kuti duhet të përcillet në KQZ bashkë me materialet e tjera, pra relatohet fakti. Gjithsesi ne në ankim do ishte më e udhës të shpjegohej kjo dhe me fjalë që ku konsistonte dëmtimi apo ku konsiston pretendimi juaj lidhur me faktin që ky dëmtim nuk është në masën e tillë, pra nëse ju e dini që është futur një kod, janë futur dy, a dinë gjë më shumë se kaq?

**Përfaqësuesi APLZHK:** Referuar kandidatëve dhe vëzhguesëve tanë pranë KZAZ-së numër 15, referohet që kjo kuti është me plasaritje dhe jo me dëmtim, pra ka një lloj dëmtimi nga pamja vizive po jo që e bën të dyshuar që mund të futet një fletë votimi apo që mund të tërhiqet sikur dhe një fletë votimi. Ndërkohë që ne pretendojmë që në atë kuti egzistojnë disa vota të cilat mund të ndryshojnë për rrjedhojë numrin e mandateve, në gjykimin tonë. Këtë mund ta shikojmë dhe nga pamja vizive se ato janë grumbulluar he nëqoftëse e gjykoni ju të arsyeshme..

**Z. K. Bele:** Kutia ku gjendet tani?

**Z. Y. Merkaç:** Kutia gjendet në magazinat tona në Lundër. Ideja është që duhet të marrim një protokoll të shohim pse KZAZ-ja, nëqoftëse KZAZ-ja e ka marr në dorëzim si të parregullt apo e ka konsideruar si të rregullt dhe e ka shpallur më vonë? Prandaj na duhet libri i protokollit.

**Z. K. Bele:** Sipas këtij shënimi që besoj reflekton librin e protokollit.

**Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. Y. Merkaç:** Dakord, kalimi në seancë për shqyrtim.

**Z. K. Bele:** Pra vendos KAS-i i konsultuar në vend kalimin për shqyrtim në seancë, si dhe për të mundësuar procesin kërkon marrjen e provës së librit të protokollit, e cila u parashtrua, si dhe marrjen për efekt të ekonomisë kohore, administrimin e kësaj kutie pranë KQZ-së, që në eventualitet të disponojmë dhe kqyrjen e saj nga KAS nëse do jetë e nevojshme. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, caktojmë dhe datën. Tani do na ndihmojë pak dhe Jona, Ina me protokollin, me oraret të gjejmë një kohë. Atëhere po vendosim orën 14:30 si orar të seancës, ditën e enjte që është dhe data 1, duke shpresuar që do jemi në orarin e synuar. Faleminderit dhe ju!

**Vendimi nr. 155**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023  
Ora 12.03**

***RENDI I DITËS***

**“Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 83, subjekti ankues Partia Balli  
Kombëtar (Kruja)”**

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti politike**
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. K. Bele:** Çelim seancën publike të KAS-it për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore nr. 83, datë 24.5.2023, të paraqitur nga Partia Balli Kombëtar, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 293, datë 18.5.2023 të KZAZ-së nr. 20 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të Bashkisë Krujë. Shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr.1257 e vijuese. Relator i kësaj kërkesë jam zgjedhor unë Koli Bele sipas shortit. KAS është i pranishëm me pesë anëtarë. I pranishëm është edhe sekretari i Përgjithshëm. Konstatojmë që nuk ka palë të tjera të interesuara, as pala ankuese. Zoti Merkaj.

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.26.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 83 me ankues Partia Balli Kombëtar, e cila ankimon tabelën përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore, këshillin e Bashkisë Krujë. Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se nuk i përmbush kërkesat dhe pretendimet e nenit 126 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk ka referuar asnjë përshkrim të shkeljes që është bërë. Është një kërkesë e paargumentuar dhe pa asnjë provë. Kështu që kërkojmë moskalimin e kërkesës në seancën për shqyrtim. Gjithashtu, kërkesa ankimore është firmosur nga Leonard Pepa, i cili nuk është kryetar i partisë, nuk ka as autorizim. Kryetar i partisë është Adriatik Alimadhi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund të jetë, por nuk është kryetar. Kërkesa është në emër të subjektit. Kruja.

**Z. E. Lako:** Ka pasur njoftim ky për seancën e sotme?

**Z. Y. Merkaj:** Po, kemi njoftuar rregullisht.

**Z. K. Bele:** Kë keni njoftuar, Leonardin?

**Z. Y. Merkaj:** Leonardin dhe Alimadhin.

**Z. K. Bele:** Në këtë fazë pyetje nuk kemi. KAS tërhiqet për vendim.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

*Rifillon seanca*

*Ora 12.06*

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën. KAS-i, në përfundim të shqyrtimit, vendosi moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë. Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Me kaq seancën e deklarojmë të mbyllur.

**Vendimi nr. 150**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

26.05.2023  
Ora 12:09

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 67, subjekti ankues  
Bashkë Fitojmë (Kucova)”**

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele ( Mungon z. Ledio Braho)
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Parti politike** PS (Z. M. Legisi), Z. L. Maliqi
- **Të tjerë:**

**Z. K. Bele:** Çelim seancën publike të KAS-it lidhur me verifikimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore nr. 67, të ankuesit koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.5.2023 të KZAZ-së nr. 64 Bashkia Kuçovë, Qarku Berat për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Kuçovë, si dhe rinumërim dhe rivlerësim të votave për KZAZ-në nr. 64 për të gjitha qendrat. Relator i kësaj seance jam unë Koli Bele sipas shortit. KAS është në kuorum me katër anëtarë, si dhe KQZ-ja e përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm. Palë të tjera prezente kemi për ankuesin?

**Z. I. Rusmali:** Zoti Maliqi ka ardhur për kërkesën e vet, e cila do të bashkohet.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. K. Bele:** Pra, ju jeni, por jo për këtë gjë, kështu që rrini i qetë.

**Z. Y. Merkaj:** Është paraqitur një kërkesë tjetër për t'u futur si palë në këtë proces, si person i interesuar. Është Partia Socialiste. Ka paraqitur kërkesën dhe autorizimin e avokatit.

**Z. K. Bele:** Besoj për të njëjtat argumente që janë parashtruar edhe në seanca të ngjashme.

**Z. M. Legisi:** Po. Faleminderit, zoti kryetar!

**Z. K. Bele:** Atëherë, KAS i konsultuar në vend vendos pranimin e kësaj kërkesë dhe legjitimimin si palë në proces të Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Legisi. Zoti Merkaj.

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se i plotëson tre elementet formale të parashikuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor: kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e kësaj çështjeje, legjitimimi i ankuesit për t'u drejtuar KAS-it për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit, si dhe është bërë brenda afatit të përcaktuar, brenda afatit 5-ditor. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it kalimin e çështjes në seancë publike. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Pyetje në këtë fazë nuk kemi. Atëherë KAS-i tërhiqet për vendim dhe i konsultuar në vend vendos kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtimin në themel. Gjithashtu, relatohet që për këtë çështje me të njëjtin objekt, me kërkues palë tjetër

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. K. Bele:** Pyetje në këtë fazë nuk kemi. Atëherë KAS-i tërhiqet për vendim dhe i konsultuar në vend vendos kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtimin në themel. Gjithashtu, relatohet që për këtë çështje me të njëjtin objekt, me kërkesë palë tjetër është regjistruar kërkesa ankimore nr. 74, që lidhet me vendimin e KZAZ-së nr. 64 për Bashkinë Kuçovë, Qarku Berat. Në këto kushte këto kërkesa duhet të bashkohen dhe të shqyrtohet si një kërkesë e vetme dhe duke respektuar parimin kërkesës së depozituar më parë, e cila është ajo me numër 67, e paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, e cila po vlerësohet sot, kërkesa nr.74 bashkohet me kërkesën nr. 67 dhe do të shqyrtohen së bashku. Relator i kësaj kërkesë do të jem unë Koli Bele dhe do të caktojme edhe datën për këtë kërkesë. Caktohet si afat data 1, ora 13.30. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 151, 152**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023  
Ora 12.14**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 86, subjekti ankues  
PLL (Kamëz)”**

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj,
- **Parti politike** PLL
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Lako:** Çelim seancën publike të KAS-it për verifikimin, për plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore nr. 86, datë 25.5.2023, të paraqitur nga Partia Lëvizja e Legalitetit me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 536, datë 20.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kryetar të bashkisë dhe për këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV-të nr. 1575 dhe nr.1597/2. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë Elvin Lako sipas shortit të hedhur në KQZ. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS-it, administrata e përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, si dhe për palën ankuese... Ju lutem, identifikohuni me mikrofon.

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. N. Sulaj:** Nazif Sulaj, përfaqësues i Partisë Lëvizja e Legalitetit, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak në Kamëz.

**Z. E. Lako:** Jeni besoj me autorizim?

**Z. N. Sulaj:** Po..

**Z. E. Lako:** Dorëzoheni pranë administratës. Faleminderit! Për palët e interesuara ka ndonjë kërkesë, zoti Merkaj?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, nuk ka.

**Z. E. Lako:** Mirë. Atëherë, zoti Merkaj, shkurtimisht dy fjalë rreth kësaj çështjeje në lidhje me plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes.

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se tek objekti i padisë ndoshta duhet të ishte më i qartë, ndërsa elementet e tjera i plotëson, ndaj i kërkojmë KAS-it ta kthejë për plotësim të objektit të ankimit.

**Z. E. Lako:** Më i qartë në lidhje me objektin. Çfarë nuk është plotësuar?

**Z. N. Sulaj:** Të nderuar anëtarë të KAS-it, të nderuar pjesëmarrës. Zgjedhjet...

**Z. E. Lako:** Zoti Merkaj, në lidhje me objektin, çfarë nuk është i qartë dhe çfarë duhet të plotësojë?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. Y. Merhaj:** Kundërshtimin e vendimit të KSHZ-së.

**Z. E. Lako:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Në objektin tuaj të kërkesës ankimore kërkohet pavlefshmëri për dy qendra votimi, ndërkohë në trup, në shpjegim ju thoni “këto dy qendra janë shpallur të pavlefshme”. Tani çfarë kërkoni, të shpallim të pavlefshme atë që është shpallur e pavlefshme?

**Z. N. Sulaj:** Ne kërkojmë, siç e parashikon edhe neni 138, pika 4, i Kodit Zgjedhor, hetim të thelluar për këto dy qendra votimi.

**Z. I. Rusmali:** Po pastaj çfarë të bëjmë mbasi t’i hetojmë?

**Z. N. Sulaj:** Në qoftë se rezultojnë që në këto qendra nuk ka ndërhyrje dhe pajisjet elektronike kanë prodhuar vullnetin e qytetarëve, të njihet në rezultatin zyrtar të KQZ-së.

**Z. I. Rusmali:** Pra, kërkoni ndryshimin e tabelës së rezultatit dhe plotësimin me rezultatin e këtyre dy qendrave të votimit.

**Z. N. Sulaj:** Sigurisht.

**Z. I. Rusmali:** Bëhet mjaftushmërisht e qartë me këtë korigjim, Ylli?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.26.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Po.

**Z. E. Lako:** Besoj e qartësuam pjesën e objektit. Pretendime të tjera nuk ka.

**Z. Y. Merkaj:** I plotëson elementet e tjera. E ka tabelën përmbledhëse të rezultatit...

**Z. E. Lako:** Provat në lidhje me këtë do t'i shqyrtojmë gjatë themelit. Ndonjë pyetje tjetër ka? Nuk ka. Mirë. KAS do të konsultohet në vend për këtë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Duke qenë se kjo kërkesë ankimore ka të njëjtin objekt si kërkesa ankimore nr. 81, e paraqitur nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", në bazë të nenit 132, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në këtë do ta bashkojmë me çështjen nr.81 dhe, meqenëse ajo çështje është depozituar më parë, kjo i bashkëlidhet asaj dhe do të shqyrtohen të dyja bashkërisht në seancën që është lënë për çështjen nr. 81, në datën 31.5.2023, ora 15.00. Relator i asaj çështjeje jam unë, kështu që unë do t'i shqyrtoj të dyja bashkërisht. Sot vendosim me kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim dhe do të shqyrtohet bashkërisht me çështjen nr. 81 në datën 31.5.2023, në orën 15.00. Me kaq e deklarojmë të mbyllur seancën.

**Vendimi nr. 153**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

